



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.12/2022

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi në konfliktin administrativ, të paditësit N.N.T. “A...” me seli në Skenderaj Rr. “...”, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas padisë së paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti – vlerësim tatimor, vlerë kontesti e pa përcaktuar, jashtë seance me datë 06.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET SE ËSHTË TËRHEQUR padia KF.nr. 12/2022 e datës 20.05.2019 e paditësit N.N.T. “A...” me seli në Skenderaj Rr. “...”, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore për padi.

A R S Y E T I M

Paditësi N.N.T. “A...” me seli në Skenderaj Rr. “...”, me padinë e datës 20.05.2019 lidhja A. nr. 1179/19, tani numri i ri KF nr. 12/2022, ka iniciuar në këtë Gjykatë konfliktin administrativ kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike: Anulim Vendimi nr. 110/2019 i datës 02.05.2019, objekt kontesti – vlerësim tatimor, vlerë kontesti e pa përcaktuar.

Në bazë të nenit 253 par. 4 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-ë), i aplikuar përshtatshmërisht sipas nenit 63 të LKA-së, ligji nr. 03/L-202, paditësi ka për detyrë që padisë t’ia bashkëngjijt edhe vërtetimin mbi pagesën e taksës gjyqësore për padi bazuar në vlerën e kontestit, ndërsa sipas paragrafit 5, të po këtij neni, nëse paditësi edhe pas vërejtjes së dërguar nga ana e Gjykatës nuk e paguan taksën gjyqësore për padi, ndërsa

nuk ekzistojnë kushtet për lirim të tij nga pagesa e taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Duke marrë për bazë faktin si më lartë, është konstatuar se këtu paditësit e ka pranuar vërejtjen për taksën gjyqësore për padi me datë 10.07.2019, mirëpo as pas kësaj, dhe as deri në nxjerrjen e këtij aktvendimi nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për padi. Gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore për ta konsideruar të tërhequr padinë e paditësit në këtë konflikt administrativ komform nenit 253, paragrafi 4 dhe 5 të LPK-së, Ligji nr. 03/L-006 i aplikuar përshtatshmërisht sipas nenit 63, të LKA-së, Ligji nr. 03/L-202, prandaj Gjykata nuk është lëshuar më tej në vendosje sipas padisë.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 253, paragrafi 4 dhe 5, të LPK-së i aplikuar përshtatshmërisht sipas nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.12/2022, datë 06.09.2022

G j y q t a r i

Fisnik NULI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.